




ANEKS KONTRATA

Date 01.09.2020

Nr. Ref. 632-20-4576-5-2-5;
632-20-071-525

Në mes të

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejshëm Autoriteti Kontraktues)

Dhe

“Berisha Com” sh.p.k- Ujëz, Gjakovë, me nr.unik 811359274 (në tekstin e mëtejshëm Kontraktuesi), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontrate

Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **“Ndërtimi-asfaltimi I rrugëve në Komunën e Gjakovës” -Kotratë dyvjeçare-Pjesa e parë: Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lipovec ,nr.prokurimit 632-19-694-5-1-1, nr.brendshëm 632-19-005-511-Loti II-të ,të datës: 22.05.2019, e cila kontratë është në realizim e sipër.**


- i. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për **Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lipovec- Loti II-të**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë, sipas ofertës së datës 26.08.2020, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Planin dinamik për kryerjen e punimeve është **10 ditë**,
3. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit prej **10%** të vlerës së kontraktuar për **40 ditë**.
4. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **10,465.20€ (dhjetëmijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë euro e njëzetë cent)** sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. **632-20-4576-5-2-5**.

5. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negocuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
6. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
7. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
8. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin

Për Autoritetin Kontraktuesin		Për Kontraktuesin	
Emri:	z.Faton Gutaj	Emri:	z.Sahit Berisha
Pozita:	Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.09.2020	Data:	01.09.2020
Vula:		Vula:	

Aneks për Rrugicat L=0+130.00 km

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I. Punët Pregaditore					
2	Pastrimi i ternit dhe prerja e shkurreve ne vendet ku pengon ne trasen e rrugës	m'	130.00	1.00	130.00 €
3	Shenjëzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet	m'	130.00	0.70	91.00 €
Gjithsej totali me TVSH - Punët Pregaditore					221.00 €
II. Punët e Gërmimit					
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne trupin e rrugës dhe ne kanalet anesore si dhe sanimi i trupit egzistues ne vendet ku është e nevojshme, bartja e tij ne deponi te pershtatshme ne largesi deri ne 15 km	m³	530.40	2.50	1,326.00 €
2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv 25-35 Mpa.	m²	780.00	0.20	156.00 €
Gjithsej totali me TVSH - Punët e Gërmimit					1,482.00 €
IV. Punët e Zhavorit					
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushes 50-150mm t=30cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >60 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	234.00	8.00	1,872.00 €
2	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-60mm, t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv>80 Mpa Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	195.00	7.00	1,365.00 €

3	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv >90 Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	78.00	7.00	546.00 €
4	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthuesit) për punimin e bankinave, t=8 cm.	m³	10.40	3.00	31.20 €
Gjithsej totali me TVSH - Punët e Zhavorit					3,814.20 €
V. Punët e Asfaltit					
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfalt betonit AB 0/16 mm në rrugë, t=8cm	m²	520.00	8.40	4,368.00 €
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfalt betonit AB 0/16 mm në rrugë me trashësi t=8cm, për rregullimin e kyqjeve ne rrugët kryesore dhe çasjeve te rrugëve ndihmese	m²	50.00	8.40	420.00 €
Gjithsej totali me TVSH - Punët e Asfaltit					4,788.00 €
VII. Testimet e nevojshme për realizimin e projektit					
1	Testimet e Ngjeshmëris	paushall	1.00	80.00	80.00 €
2	Testimet e Asfaltit	paushall	1.00	80.00	80.00 €
Gjithsej totali me TVSH - Testimet e nevojshme për realizimin e projektit					160.00 €

REKAPITULLIMI		
I	Punët Pregaditore	221.00 €
II	Punët e Dheut	1,482.00 €
IV	Punët e Zhavorit	3,814.20 €
V	Punët e Asfaltit	4,788.00 €
VII	Testimet e nevojshme për realizimin e projektit	160.00 €
Gjithsej totali me TVSH		10,465.20 €



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVES
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	11.11.2019
Për:	Zyrën e prokurimit – z. Faton Gutaj
Përmes:	
Nga:	Menaxheri i Projektit – Rexhë Rexha;
Kopje:	DSHP- z. Shkumbin Kastrati AI Engineering, Prishtinë; z. Ardian Gjini – Kryetar i Komunës
Lënda:	Kërkesë për punime shtese

Fillimisht ju njoftojmë se punimet e projektit me titull: NDERTIMI -ASFALTIMI I RRUGEVE NE KOMUNEN E GJAKOVES, - Kontrate dy vjeqare – pjesa e pare e cila është duke u realizuar nga operatori ekonomik NPT "Berisha Com", Gjakovë sipas kontratës me nr. identifikimi 632-19-005-511 – Lot. II në vlerë prej 124,256.33€. Mirëpo gjatë realizimit të punimeve në projektin e lartcekur ka pasur keresa per punime shtes ne pozicionet e cekura me poshtë.

Bazuar ne kërkesën e qytetareve te datës 11.07.2019, punekryesi me datën 22.07.2019 ka kërkuar punime shtesë duke e njoftuar Organin Mbikëqyrës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike . Organi mbikëqyrës iu është përgjigjur kërkesës me datën 06.11.2019 duke i arsyetuar punimet sipas përshkrimit sipas tabelarit te sjellur nga Operatori Ekonomik..

I. Punët Pregaditore

2. Pastrimi i terenit dhe prerja e shkurreve ne vendet ku pengon ne trasen e rrugës Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne trupin e stazave dhe aprkingut, bartja e tij ne deponi te pershtatshme ne largesi deri ne 15 km. Në këtë pozicion është llogaritur edhe gërmimi i kanalit
3. Shenjzimi i trasesë dhe përcjellja e punimeve me gjeodet

II. Punët e Gërmimit

1. Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne trupin e rrugës dhe ne kanalet anesore si dhe sanimi i trupit egzistues ne vendet ku është e nevojshme, bartja e tij ne deponi te pershtatshme ne largesi deri ne 15 km
2. Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet të jetë Mv 25-35 Mpa.

IV. Punët e Zhavorit

1. Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e materialit gurorë mbushës 50-150mm t=30cm (kurse ne rrugicën e parë 40 cm). Moduli i shafitjes duhet të jetë $M_v > 60$ Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e materialit mbushës për rregullimin e kyqjeve anësore.
2. Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-60mm, t=20cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë $M_v > 80$ Mpa Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e zhavorit për rregullimin e kyqjeve anësore.
3. Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm t=10cm. Moduli i shafitjes duhet të jetë $M_v > 90$ Mpa. Në këtë pozicion është llogaritur edhe sasia e zhavorit për rregullimin e kyqjeve anësore.
4. Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (material shterp nga gurthuesit) për punimin e bankinave, t=8 cm.

V. Punët e Asfaltit

1. Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfalt betonit AB 0/16 mm në rrugë, t=8cm
2. Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e asfalt betonit AB 0/16 mm në rrugë me trashësi t=8cm, për rregullimin e kyqjeve ne rrugët kryesore dhe çasjeve te rrugëve ndihmese

VII. Testimet e nevojshme për realizimin e projektit

1. Testimet e Ngjeshmërisë
3. Testimet e Asfaltit

Sipas paramases dhe parallogarisë del se vlera e këtyre punimeve është 10,465.20 €. Për të përfunduar projekti i rrugës janë domosdoshme punime shtesë te verifikuara me matje në teren.

Andaj kërkohet nga Zyra e Prokurimit për Aneks Kontratë të punimeve shtesë ne vlerë prej 10,465.20 €.

Shkresës ja bashkëngjisim edhe Kërkesën e qytetareve, Operatorit ekonomik NPT "Berisha Com", Gjakovë dhe përgjigjen e Organit mbikëqyrës " Al Engineering".

Kësaj shkrese ja bashkëngjisim

- QYTETAREVE
- Kërkesën e OE
- Përgjigjen e Organit Mbikëqyrës dhe tabelën e llogaritur

Me respekt

KOMUNA E GJAKOVËS

**NJOFTIM PËR KOMISIONIN RREGULLTIVE TË
PROKURIMIT PUBLIK**

Sipas Nenit 35.1 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 068 dhe ligjin Nr. 05/L-092



Për	Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik
Përmes	Ardian Gjini
Nga	Faton Gutaj
Lënda	Njoftim për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë
Titulli i aktivitetit të prokurimit	Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare-Pjesa e Parë Lot II-Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lipovec
	632-20-4576-5-2-5
	632-20-071-525
Data	20.08.2020

Sipas nenit 35.2 të LPP, autoriteti kontraktues, pa ndonjë qëllim për të diskriminuar kundër apo në favor të ndonjë operatori ekonomik, ka përdorur Procedurën e Negociuar pa publikim të Njoftimit për Kontratë. Arsyeja për marrjen e këtij vendimi:

Neni 35.2.4(ii): punë apo shërbime të reja të përbëra nga përsëritja e punëve ose shërbimeve të ngjashme të besuara te operatori ekonomik të cili i ishte dhënë kontrata origjinale nga autoriteti kontraktues

SHPJEGIM

Fillimisht ju njoftojmë se punimet e projektit me titull Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në Komunën e Gjakovës-Kontratë dy vjeçare-Pjesa e Parë Lot II të e cila është duke u realizuar nga Operatori Ekonomik N.P.T. "Berisha Company" sh.p.k., Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Lipovec sipas kontratës me nr. identifikimi 632-19-005-511- Lot II në vlerë prej 124.256,33€. Mirëpo gjatë realizimit të punimeve ka pasur kërkesa për punë shtesë. Bazuar në kërkesën e qytetarëve me datën.11.07.2019, punëkryesi me datën 22.07.2019, ka kërkuar punime shtesë duke e njoftuar organin mbikëqyrës dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Organi mbikëqyrës iu është përgjigjur kërkesës me datën 06.11.2019, duke i arsyetuar punimet sipas përshkrimit sipas tabelarit të sjellur nga Operatori Ekonomik. Sipas paramasës dhe parallogarisë del se vlera e këtyre punimeve është 10.465,20€. Për të përfunduar projekti i rrugës janë të domosdoshme punime shtesë të verifikuara me matje në terren.

INFORMATAT SHITESË:

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka të drejtë të kërkojë çdo informatë shtesë të nevojshme nga Autoriteti Kontraktues

Zyrtari i Prokurimit: **Faton Gutaj**

Nënshkrimi:

Informatat kontaktuese:

Tel: 038-200-44041

E-mail: faton.gutaj@rks-gov.net

Faksi:



SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **Komuna e Gjakovës**

(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **BERISHA COM SH.P.K. , FSH-UJEZ-GJAKOVE** Gjakove

(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: **NDERTIMI -ASFALTIMI I RRUGEVE NE KOMUNEN E GJAKOVES-KANTRAT DY VJEQARE**
LOT-II-NDERTIMI -ASFALTIMI I RRUGES NE FSH.LIPOVEC
ME NR.PROKURIMIT-632-20-4576-521

Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Nje mije e e Katerdhjete e Gjasht e Pesedhjete e Dy 1,046.52 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim;

a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe

b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,046.52 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **40 ditë prej 01.09.2020 deri më 11.10.2020**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i bankës ose i institucionit financiar

K.S. "SIGKOS" Sh.a.
Rr.Sylejman Vokshi,Pallati i kuq L-B nr.1,Prishtinë

Data
01.09.2020